

ÇRREGULLIMI INFORMATIV

NË PERIUDHËN E DYTË
TË VITIT

2022

Janar, 2023

HIBRIDO.INFO

Çrregullimi informativ në periudhën e dytë të vitit 2022

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, janar 2023

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



AUTOR:

Alban Bokshi

Hulumtues/kontrollues të fakteve:

Fatbardh Dema

Festim Rizanaj



Visit our website
www.hibrid.info



Na gjeni në Facebook
[@hibridinfo](https://www.facebook.com/hibridinfo)



Na gjeni në Youtube
[@hibrid info](https://www.youtube.com/channel/UC...)



Na gjeni në Twitter
[@hibridinfo](https://twitter.com/hibridinfo)



Na gjeni në LinkedIn
[@hibrid.info](https://www.linkedin.com/company/hibrid.info)

Zyrat tona:
Rruga Venet Bajrami, Hyrja B, Residio 5
Nr.10, Kati III
Prishtinë, 10000
Kosovë
+383 (0) 44 313 428
info@hibrid.info

PËRMBAJTJA

6

Përfundim: Rekomandimet dhe sugjerimet.....29

5

Rregullimi dhe vetërregullimi i mediave.....25

4

Praktika dhe mjedisi gazetaresk: rrethanat dhe konteksti.....21

3

Analizë e raporteve mujore.....11

2

Konteksti politik dhe socio-ekonomik i çrregullimit informativ.....09

1

Konteksti mediatik i çrregullimit informativ.....07

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues, i pari i këtij lloji në Kosovë, deri më tani, pasqyron gjendjen e çrregullimit informativ gjatë periudhës korrik-dhjetor 2022, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është monitorues e analitik dhe përshkruan gashëmujorin e dytë të vitit të kaluar.

Ky raport është i ideuar nga platforma për kontroll të fakteve hibrid.info, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetët nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Qëllimi i këtij raporti është analizimi dhe raportimi mbi ekosistemin e çrregullimit informativ në Kosovë. Për arritjen e këtij qëllimi, në këtë raport janë trajtuar pikëpamje të ndryshme që janë përmbledhur në tri pjesë: i) pjesa e parë e raportit i analizon gjetjet e raporteve mujore të Hibrid.info mbi çrregullimin informativ në Kosovë, ii) pjesa e dytë i analizon praktikën dhe mjedisin gazetaresk në Kosovë, përmes analizës së ekosistemit të mediave, dhe iii) pjesa e tretë trajton rregullimin dhe vetë-rregullimin e mediave, rolin e akterëve të ndryshëm politikë, institucionalë e shoqërorë në këtë drejtim. Të tria këto janë të ndërlidhura dhe ndikojnë tek njëra-tjetra duke krijuar një ekosistem mediatik i cili është i vendosur në një kontekst më të gjerë shoqëror, politik e ekonomik.

Ky hulumtim zbulon sesi ngjarjet në fushën e politikës dhe atë socio-ekonomike ushqejnë prodhuesit e përmbajtjeve keqinformuese, rrjedhimisht ndikojnë edhe në aspektin e informimit e komunikimit. Në raport gjithashtu, paraqiten informacione, fakte e të dhëna për ndikimin që kanë ngjarjet aktuale të nivelit të lartë tematik në prodhimin e përmbajtjeve keqinformuese.

Lufta në Ukrainë dhe përpjekjet e Perëndimit për ta arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë janë dy ndikimet më të mëdha gjeopolitike, të cilat u japin kahje raportimeve mediatike. Këto dy tema, rrjedhimisht, shërbyen në masë të madhe në krijimin e përmbajtjeve keqinformuese.

Në këtë raport analizohen gjetjet e raporteve mujore monitoruese të hybrid.info, nga ku janë trajtuar forma dhe mënyra se si janë sjellë këto përmbajtje keqinformuese tek audienca.

Përmbajtja keqinformuese, si pjesë e një narrativi politikë që ndërlidhet me zhvillimet për dhe rreth Kosovës, kryesisht është krijuar nga përfaqësues politikë e institucionalë serbë dhe disa media në gjuhën serbe.

Përderisa, sipas të dhënave të hulumtimit të Hybrid.info, mediat kosovare janë kryesisht të përfshira në lajme "clickbait"[1] me synimin që ta rrisin numrin e vizitorëve në faqet e tyre. Megjithatë, ka raste të shpeshta kur mediat kosovare shpërndajnë edhe dezinformata dhe lajme të rreme të ndikuara, kryesisht nga faktorë të jashtëm, duke mos bërë verifikim informacioni. Kjo ndodh qëllimshëm dhe, shpeshë herë edhe në mënyrë të pavetëdijshme, për shkak të problemeve të brendshme të ekosistemit mediatik në Kosovë.

Ky raport identifikon dy probleme kryesore me të cilat ballafaqohen mediat në Kosovë: i) mungesa e profesionalizmit dhe resurseve humane e financiare dhe ii) mungesa e mbikëqyrjes efektive nga organet përgjegjëse për to dhe mungesa e vetërregullimit të mediave.

Këto dy mangësi të evidentuara, por edhe disa të tjera, i bëjnë mediat kosovare të jenë lirshëm shpërndarës të përmbajtjeve keqinformuese.

[1] Këtë shprehje do të mund ta përkthenim në shqip si "lajme-grep" ose "lajme-karrem" qëllimi i të cilave është ta tërheqin lexuesin drejt klikimit mbi artikujt e mediave që postojnë lajme të tilla.

Sikurse çdo lajm apo raportim i rregullt mediatik, edhe çrregullimi informativ vepron mbi një kontekst politik, shoqëror e ekonomik. Madje edhe kur lëshohet një shpifje për qëllime dezinformimi apo rritje klikimesh në faqe të synuara, e cila në shikim të parë mund të na duket e padëmshme, ajo lëshohet mbi një kontekst më të gjerë politik dhe në një mjedis mediatik i cili mundëson qarkullimin e lajmeve të tilla.

Qarkullimi dhe shpejtësia e lajmeve është mundësuar në mënyrë të pakthyeshme me lindjen e internetit dhe, bashkë me të, edhe të mediave sociale të cilët kanë mundësuar shumimin e paprecedent të mediave në nivel global. Ky shumim i pashembullt i mediave dhe i mundësive për të prodhuar lajme nga kudo dhe cilido, ka prodhuar edhe pasojat e padëshiruara dhe të paparashikueshme të çrregullimit masiv informativ. Jo vetëm vende si Kosova, por edhe vendet me traditë mediash si ato të Evropës Perëndimore e ShBA-të u gjendën para një situatë të panjohur kur u bënë së pari cak fushatash dezinformimi nga vende të treta.

Situata ndërlikohet kur marrim parasysh vetëm sferën online të mediave, e cila karakterizohet nga faqe të panumërta online si dhe në mediat sociale si Facebook, Twitter e tash së voni edhe në platforma të tjera si Tik Tok. Ndërlikimi buron nga fakti se është pothuajse e pamundur të mbikëqyren, kontrollohen e sanksionohen të gjitha këto faqe. Të paktën në Kosovë ende mungojnë përpjekjet serioze për rregullim dhe mbikëqyrje të tyre, pavarësisht raporteve e brengave të shprehura në forma e forume të ndryshme.[2] Numri i mediave online që nuk janë anëtarësuar pranë Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) vetëm sa është rritur, ndërsa fakti që pronësia, veçanërisht e mediave online, mbetet shpesh e panjohur dhe e rreme[3] vetëm sa e vështirëson rregullimin e kësaj fushe.

[2] Shih Raportin e Progresit të Komisionit Evropian mbi Kosovën Kosovo Report 2022.pdf (europa.eu), faqe 34 dhe 94 përkatësisht.

[3] Shih Raportin e Progresit mbi Kosovën Kosovo Report 2022.pdf (europa.eu), faqe 34.

Mbikëqyrja e tregut mediatic, aktualisht bëhet nga disa trupa rregullues dhe vetërregullues. Trupi vetërregullues i ngarkuar për mbikëqyrjen e mediave të shtypura dhe online në Kosovë është Këshilli i Mediave të Shkruara (KMSHK). Ndërsa, trupi rregullues për mbikëqyrjen e mediave audiovizuale (Radiot dhe Televizionet) është Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM). Megjithatë, problemet kryesore me të cilat ballafaqohen këta dy mekanizma janë mungesa e një kompetence ekzekutive, problemet me financa, resurse njerëzore, e përkrahja politike apo shoqërore.

Duke marrë parasysh se nuk ka më asnjë gazetë që botohet si e shtypur, edhe informimi i publikut është reduktuar te faqet e ndryshme online dhe te televizionet si mënyrë tradicionale e të informuarit. Përqindja e lartë e penetrimit të internetit në Kosovë (rreth 97%), si dhe qasja e lartë në të, përmes pajisjeve të ndryshme siç janë telefonat e mençur e tabletat (mbi 60%), rritë mundësinë për ta manipuluar opinionin publik është e madhe dhe paraqet shqetësim që duhet adresuar.[4]

97%

Përqindja e penetrimit të internetit në Kosovë

60%

Qasje përmes pajisjeve siç janë telefonat e mençur e tabletat

2] Shih Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit 2021.pdf (ASK), faqe 34 dhe 94 përkatësisht.

Konteksti politik i çrregullimit informativ për dhe rreth Kosovës është i dominuar nga zhvillimet politike dhe të sigurisë, veçanërisht nga zhvillimet në raport me Serbinë, përkatësisht temat e dialogut, veriut të Kosovës, Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe të tjera. Sipas raportit të IREX-it qytetarët e Kosovës më së shumti i përcjellin zhvillimet politike në vend dhe kjo përputhet edhe me gjetjet e raporteve mujore të Hibrid.info të cilat zbulojnë se fusha ku më së shumti gjenerohet shtrembërim informativ është politika, ndërsa më së shumti shtrembërim informativ i kategorisë “dezinformatë” (shih më poshtë për kategoritë specifike) krijohet përmes lajmeve që lidhen me dialogun dhe çështjet tjera të pazgjidhura në raport me Serbinë.

Këto publikime keqinformuese kanë trajtuar kryesisht tema politike dhe të sigurisë për dhe rreth veriut të Kosovës, masat reciproke të Qeverisë së Kosovës me autoritetet e Serbisë për targa dhe automjeteve, pretendimet e pabaza për konflikt në veri, Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, "luftërat" që thuhet se Albin Kurti do t'i nisë kundër serbëve e Serbisë, etj. Edhe në rastet kur ngjarjet që trajtojnë direkt marrëdhëniet Kosovë – Serbi, nuk janë dominuese, prapë, sipas raporteve mujore të Hibrid.info, vërehet se politika mbetet si fusha më atraktive që përdoret për keqinformim, siç mund të shihet në raportin e muajit nëntor. Mediat vendore, në anën tjetër, përdorin një shumësi mënyrash keqinformimi dhe nuk janë të përqendruara vetëm në një fushë. Mund të thuhet se ato nuk kanë një fushë të veçantë dhe as nuk kanë vetëm një synim të veçantë. Por, mënyra me e shpeshtë e përmbajtjeve keqinformuese, që mediat kosovare e përdorin, janë ato që vlerësohen si “clickbait”.

Mund të konkludohet se, në këtë gjashtëmuor korrik-dhjetor 2022, llojet e keqinformimit si dezinformimi dhe clickbait-i kanë qenë një konstantë e keqinformimit të cilat kanë dominuar në këtë periudhë, pavarësisht luhatjeve të kohëpaskohshme. Fushat e politikës dhe sigurisë kanë qenë konstanta tjetër që ka dominuar për nga shumësia e keqinformimit që është prodhuar përmes tyre. Mund të themi se këto dy fusha e përbëjnë kontekstin politik dhe më gjerë atë gjeopolitik e gjeostrategjik të keqinformimit në Kosovë. Për aq kohë sa do të vazhdojnë tensionet mes Kosovës dhe Serbisë dhe nuk arrihet një marrëveshje për normalizimin e raporteve bazuar në besim të ndërsjellët, mund të presim se do të vazhdojë edhe info-lufta e Serbisë ndaj Kosovës përmes dezinformimit të vazhdueshëm, që bëhet kryesisht nga deklaratat e udhëheqësve politikë e institucionalë dhe mediat e afërta me pushtetin në këtë vend.

I . ANALIZË E RAPORTEVE MUJORE

Çrregullimi informativ në tërësi, siç e kemi quajtur në metodologjinë e hulumtimit, është emri përkufizues për lloje e mënyra të ndryshme keqinformimi. Për t'i kapur të gjitha mënyrat dhe format në të cilat ai zhvillohet, Hibrid.info e ka ndarë keqinformimin në disa kategori vlerësimi, bazuar edhe në metodologjinë e punës, të pranuar nga Rrjeti Ndërkombëtar për Kontrollimin e Fakteve (International Fact Checking Network – IFCN), si: dezinformim, clickbait, teori konspirative, manipulim i fakteve, lajme të rreme, përmbajtje të paverifikuara, raportime gabim, etj.[4]

Ky klasifikim na ndihmon ta sistemojmë keqinformimin në mënyrë që ta kapim mënyrat sesi ai

përçohet e degëzohet, duke na ndihmuar të mësojmë më shumë për kontekstin, qëllimet, akterët dhe institucionet e përfshira në keqinformim.

Për këtë periudhë, Hibrid.info ka prodhuar gjashtë raporte mujore që e monitorojnë gjendjen e keqinformimit në Kosovë, nga korriku deri në dhjetor 2022. Synimi është të jepet një sqarim më objektiv rreth gjendjes së informimit dhe të shpjegohen tendencat e keqinformimit për periudhën monitoruese. Sa i përket metodologjisë, Hibrid i krahason të dhënat mbi çrregullimin informativ në çdo raport mujor të grumbulluara përmes databazës së tyre përmes pesë kategorive krahasuese.

Ato janë:

1

Vlerësimet e artikujve keqinformues.

2

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese.

3

Institucionet dhe personat/zyrtarët e përfolur në artikuj keqinformues.

4

Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese.

5


Hapësira gjeografike e mediave që kanë krijuar e shpërndarë keqinformim.

[4] Këtu janë renditur vetëm ato kategori vlerësimi të cilat shfaqen në raportet mujore. Për t'i parë të gjitha kategoritë shihni shihni faqen e hibrid.info, Metodologjia.

1. KATEGORITË VLERËSUESE TË KEQINFORMIMIT

Në pjesën e Kategorive Vlerësuese të Keqinformimit diskutohet se të çfarë natyre janë shtrembërimet dominuese informative, nëse ato janë clickbait, dezinformatë, raportim gabim, apo të ndonjë kategorie tjetër. Sipas të dhënave të grumbulluara për periudhën gjashtë mujore, më së shumti keqinformim është shpërndarë në kategorinë dezinformatë e cila prin me 28.2%. Menjëherë pas kësaj kategorie

vijnë lajmet clickbait me 25.4%, duke e konfirmuar kështu tendencën e vërejtur në raportet mujore të dominimit të vazhdueshëm të këtyre dy kategorive të para. Për shembull, në katër raportet e para mujore shihet se dominojnë artikujt dezinformues dhe clickbait (deri në 32%-33% secila), me një dominim paksa më të lartë të atyre dezinformues.




Kësisoj, në korrik, dezinformimi ishte tek 42%, ndërsa clickbait tek 19%. Kjo bëhet e kuptueshme kur e shohim se në fund të muajit korrik ishte lart në agjendë vendimi i qeverisë së Kosovës për konvertimin e targave serbe në ato kosovare. Meqenëse vendimi për targat u shty për dy muaj, kjo u reflektua edhe në raportin e gushtit ku dallimi mes dezinformimit dhe clickbait-it u ngushtua tek 23%, përkatësisht 25%. Në shtator, prapë ngrihet dezinformimi në 29%, e clickbait bie në 22%, ndërsa në tetor shohim ngritje të të dyjave: dezinformimi 32%, ndërsa clickbait 33%.

Befasi e këtyre raporteve është ai i nëntorit në të cilin dezinformimi bie për herë të parë në vend të tretë, në

vetëm 9% duke, u zëvendësuar nga artikujt e vlerësuar me “Përmbajtje e paverifikuar” me 25%, dhe Clickbait me 31%.[5]

Clickbait i quajmë ata artikujt keqinformues, qëllimi i të cilëve është tërheqja e klikimeve, kryesisht me qëllim përfitimi financiar, duke vënë tituj tërheqës që nxisin lexuesit t’i hapin artikujt. Ndërsa dezinformues është ai raportim mediatik i cili në vete përmban një “miks” të burimeve të pasakta apo edhe përmbajtje gjysmë të vërtetë. Si “përmbajtje e paverifikuar” i quajmë lajmet që nuk ofrojnë informata të mjaftueshme për t’i konfirmuar pretendimet e bëra për shkak të mungesës ose mosposedimit të burimeve të besueshme.



[5] Të gjitha raportet mujore të prodhuara nga Hibrid.info mund t’i shihni te linku vijues: Raportet Mujore Monitoruese - (hibrid.info).

Shumica e lajmeve me përmbajtje të paverifikuara kanë ardhur nga disa media në gjuhën serbe, të cilat lajme renditen në vendin e tretë për këtë gjashtëmuorë me 11.8%. Pra, mund të thuhet se aktiviteti keqinformues nga ato media nuk ka rënë, por ka vetëm ndryshim në formën e keqinformimit. Meqenëse edhe nëntori ishte muaj i nxehtë politikisht në raportet me Serbinë, kjo u reflektua edhe në të gjitha vlerësimet keqinformuese.

Si Analizë e llojeve të vlerësimeve, nëse i shikojmë vetëm dy kryesoret për muajin korrik, shohim se një pjesë e madhe e artikujve keqinformues me vlerësimin “dezinformata” kanë qenë ata që, në përmbajtje kanë trajtuar ngjarjet politike, të dominuara nga ato që ndërlidhen me zhvillimet rreth raporteve Kosovë-Serbi. Ndërsa vlerësimin “clickbait” e kanë marrë ata artikuj keqinformues që kanë përdorur kryesisht tema sociale si “tërheqja e 30-përqindëshit nga Trusti”, “nëgritja e çmimeve”, “liberalizimi i vizave” e të ngjashme. Të njëjtin model e shohim të zhvillohet edhe përgjatë muajve vijues, por duke u shtrirë edhe në fusha të tjera.


Temat tjera që i shohim të na paraqiten në raportet mujore e të cilat shfaqen varësisht nga zhvillimet në terren janë: “lajme të rreme” që shfaqet rregullisht (renditet si e treta në korrik), “teori konspirative” (e treta në gusht), dhe “manipulim i fakteve” e lajme të raportuara “gabim” që shfaqen në përqindje shumë më të vogla se këto dy të parat.

2. TEMAT E PËRDORURA PËR KRIJIMIN DHE SHPËRNDARJEN E PËRMBAJTJEVE KEQINFORMUESE

Siç u tha edhe më lart, një konstantë e keqinformimit në Kosovë janë marrëdhëniet me Serbinë dhe tensionet e kohëpaskohshme që kanë karakterizuar gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022, veçanërisht rreth veriut të vendit. Si temë e përdorur për krijimin dhe shpërndarjen e lajmeve keqinformuese, veriu i Kosovës dominon në vendin e parë me 12.3%. Ndërsa dialogu Kosovë – Serbi zë vendin e tretë me 3.1%. Por, nëse i shohim këto dy si të ndërlidhura, ato bashkë i bëjnë 15.4% të temave të përdorura për keqinformim.

Duke qenë ndër temat më të përcjella në vend nga qytetarët dhe marrë parasysh shpeshtësinë e debateve të përnatshme televizive rreth tyre, atëherë është e qartë pse këto tema janë kryesoret.

Nëse këtyre temave ua shtojmë edhe temën e komunave me shumicë serbe me 1.9% dhe marrëdhëniet Kosovë-Serbi me 1.4%, na del se këto tema i mbulojnë pothuajse 1/5 e lajmeve keqinformuese me 18.7%.



Lufta në Ukrainë dhe temat që kanë pasuar si rezultat i kësaj lufte si p.sh. inflacioni, shtrenjtimi i çmimeve, furnizimi me rrymë, nafta, etj., janë pre e keqinformimit duke prodhuar një numër të madh të lajmeve keqinformuese në Kosovë. Marrë parasysh se ajo çfarë ndodh në Ukrainë dhe rreth luftës atje ka edhe implikime në Kosovë, edhe qytetarët i përcjellin këto ngjarje duke ndikuar që të ketë keqinformim në rritje në fusha të caktuara, kryesisht të natyrës socio-ekonomike. Kësisoj shohim se çmimet si temë e keqinformimit gjenden në vendin e dytë me 5.2%, ndërsa skemat sociale në vendin e katërt me 2.6%, ndonëse vetë lufta në Ukrainë përbën vetëm 1.4% të temave keqinformuese.

Temat tjera që i shohim të shfaqen në muaj të ndryshëm, varësisht zhvillimeve në terren janë: liberalizimi i vizave 2.4%, greva në arsim 1.2%, kombëtarja e Zvicrës dhe shqiptarët 1.2%, etj.

Është interesant fakti se në muajin nëntor dhuna ndaj të moshuarës në Pejë ishte e treta në renditje si temë, mbi bazën e së cilës, u keqinformua. Kjo temë u rendit menjëherë pas raporteve Kosovë – Serbi dhe temës së veriut. Disa media në gjuhën serbe, duke u nisur kryesisht nga artikulli i Alo.rs e shfrytëzuan rastin e saj për të gënjyer se kinse ajo ishte grua e moshuar serbe e cila po keqtrajtohej nga infermieret shqiptare. Kjo ishte raportuar edhe nga disa media spanjolle si e tillë, por pas raportimit nga Hibrid.info ishte bërë e ditur se ky ishte një rast klasik keqinformimi.


3. LLOJET E FUSHAVE

Një analizë e katër raporteve të fundit, pra që nuk gjendet në dy të parat, është diskutimi rreth llojit të fushave që e dominojnë çrregullimin informativ. Në këtë aspekt shohim një dominim pothuajse absolut të politikës si fushë me 39.8%, pasuar nga fusha e çështjeve sociale me 22.1% dhe nga siguria me 16.5%. Nëse në këtë kontekst e shohim politikën si të ndërlidhur me sigurinë, pasi këto dyja i reflektojnë sfidat e sigurisë dhe ato politike në veri dhe në raport me Serbinë, atëherë ato i përbëjnë 56.3% të fushave të keqinformimit.

Këto shifra verifikohen edhe në raportet mujore pasi, në shtator,

politika ishte tek 29%, në tetor te 53%, dhe në nëntor 38%, pasuar nga siguria me 25%.

Fushat tjera si ekonomia, arsimi apo shëndetësia shfaqen në raport gjashtëmujorë me nga 4%, përkatësisht 2% dhe 1.2%. Fushat në të cilat është shfaqur keqinformimi na tregojnë për llojin e lajmeve që u shërbehet lexuesve në Kosovë e prandaj edhe e shohim shumicën e çrregullimit tek lajmet e politikës. Por në anën tjetër, shohim se fusha sociale është e dyta si fushë keqinformimi, ndarje e cila përkon me ndarjen në temat e përdorura dhe në kategoritë vlerësuese.



4. LLOJET E PUBLIKUESVE


Sa i përket burimit të këtyre lajmeve apo llojet e mediave publike, Hibrid i ka ndarë ato në dy lloje: në media reale dhe portale të dyshimta. Media reale janë ato që u dihet vendi i origjinës, që janë të regjistruara si entitete juridike, si biznese apo OJQ, që kanë të dhëna për dhe rreth aktivitetit të tyre siç është pronësia, menaxhmenti, impresumi, adresa, stafi dhe të tjera. Ndërsa media apo portale të dyshimta janë ato për të cilat mungojnë këto të dhëna apo i kanë ato vetëm si të pjesshme.[6]

Tek mediat reale prijnë mediat vendore, pra të Kosovës, në vend të

dytë vijnë ato rajonale me përqindje më të ulët, pastaj edhe mediat ndërkombëtare apo ato të diasporës shqiptare. Sa i përket keqinformimit, përveç në korrik ku kanë dominuar portalet e dyshimta, në të gjithë muajt tjerë dominojnë mediat reale me keqinformim. Mediat vendore kanë prodhuar lajme clickbait, teori konspirative, dezinformatë, lajmë të rreme, raportime gabim dhe përmbajtje të paverifikuara.

Si përqindje për këtë gjashtëmuor prijnë mediat reale me keqinformim me 52.6% kundrejt atyre të dyshimta me 47.4%.

Media të dyshimta
47.4%



Media
52.6%

[6] Shih Metodologjinë në faqen e Hibrid.info Metodologjia - (hibrid.info).

5. KLASIFIKIMI I MEDIAVE REALE NË ASPEKTIN GJEOGRAFIK


Kjo matje na tregon vetëm për mediat reale që kanë krijuar dhe shpërndarë përmbajtje keqinformuese, duke i kategorizuar ato sipas vendit (shtetit) ku janë të regjistruara si entitete. Kategorizimi i mediave në aspektin gjeografik bëhet sipas kësaj ndarjeje: mediat vendore të regjistruara në Kosovë, mediat rajonale (pothuajse gjithmonë ato serbe), mediat ndërkombëtare, dhe mediat që menaxhohen nga aktivistë të diasporës, por që kanë përmbajtje në gjuhën shqipe rreth zhvillimeve në Kosovë.

Për periudhën nën monitorim korrik-dhjetor 2022, mediat reale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese, janë ato vendore me 53.4%, pasuar nga ato rajonale me 38.5%, mediat vendore/rajonale 5.9%,

mediat ndërkombëtare 1.6%, mediat shqip nga diaspora.

Mediat e dyshimta nuk janë të përfshira në këtë matje pasi për to mungojnë të dhënat për vendin e origjinës.


Ndarja e lajmeve sipas vendit të origjinës na ndihmon të kuptojmë se çfarë lajmesh prodhohen dhe ku, e me çfarë synimesh nëse kanë të tilla. Siç u tha, mediat vendore përdorin një shumësi mënyrash të keqinformimit, nuk janë të përqendruara vetëm në një fushë dhe kryesisht prodhojnë lajme clickbait. Ndërsa përmbajtjet keqinformuese që vijnë nga mediat nga Serbia/rajoni, kanë synim dezinformimin rreth Kosovës dhe gjithnjë në fushën e politikës dhe të sigurisë



6. FIGURAT DHE INSTITUCIONET MË TË PËRFOLURA

Në kategorinë vijuese shohim se dominon figura e Albin Kurtit si më e përfolura me 14.1%, pasuar nga ajo e Aleksander Vuçiqit me 4.1%, dhe kombinime si Kurti/Petković, Kurti/Rakiq, me nga 1.2% dhe 1.8%, etj. Figurat tjera që shohim të përmenden ndër muaj janë edhe Vjosa Osmani, Xhelal Sveçla, Miroslav Lajcak e Peter Stano, etj. Pra personat më të përfolur në artikujt keqinformues të trajtuar nga hybrid.info, janë liderët politikë e institucionalë në Kosovë dhe Serbi.

Sa u përket institucioneve më të përfolura ato dallojnë nga muaji në muaj, varësisht nga temat që kanë dominuar atë periudhë. P.sh. Policia e Kosovës, në gusht e nëntor, Qeveria e Kosovës në shtator për shkak të grevës në arsim dhe targave, Trusti Pensional sa herë është aktualizuar ajo temë, KFOR-i në nëntor, etj. Si institucion përbrenda gjashtëmujorit nën monitorim prin Policia e Kosovës me 9.3%, Institucionet e Kosovës dhe Qeveria e Kosovës me nga 5.4%, Trusti e Ministria e Financave me 4.6%, përkatësisht 3.8%, etj.



II. PRAKTIKA DHE MJEDISI GAZETARESK: RRETHANAT DHE KONTEKSTI

Problemet e mediave në Kosovë janë të shumta, filluar nga ato financiare, politike, institucionale e deri te ato të mungesës së arsimit modern gazetaresk, profesionalizmit, etikës e integritetit profesional. Të gjithë këta faktorë janë të ndërlidhur dhe e ushqejnë njëri-tjetrin, për ta krijuar kështu një ekosistem specifik mediatik, në kuadër të të cilit ndodh edhe çrregullimi informativ. Pas pandemisë së Covid 19, të gjitha mediat e shtypura të Kosovës kaluan në versionin online të informimit, si pasojë e vështirësive financiare të krijuara nga pandemia, në një treg në të cilin edhe ashtu mezi mbijetonin. Ndonëse prezenca online e mediave në Kosovë tashmë ishte një fakt i krijuar prej vitesh, kriza financiare, së bashku me mundësitë e krijuara nga interneti, bëri që dinamika e shtimit të prezencës së mediave online të rritej. Llogaritet që media të regjistruara si entitete juridike (të dominuara nga ato të regjistruara si biznese), kryesisht me operim online, arrijnë në 468,[7] Shumica me redaksi të vogla, nën 5 punonjës, të cilëve, në shumicën e rasteve u mungon përvoja, shkollimi dhe profesionalizmi i kërkuar për ta filtruar informacionin dhe për të informuar drejt dhe saktë.[8] Duke qenë gazetarë të rinj dhe me mungesa, qon të prodhimi i përmbajtjeve mediatike

jo-profesionale. Gjithashtu, duke mos pasur njohuri të mjaftueshme mbi profesionin dhe kontekstin dhe rrjedhën e ngjarjeve e problemeve të hapësirë, që të njëjtin punonjës të mediave, të bien pre e narrativave të dëmshme dhe dezinformuese.[9]

Sipas një hulumtimi të vetë KMSHK-së, i realizuar përmes anketimit të tetëmbëdhjetë mediave online del se, në këto media, ka "numër të vogël redaktorësh", "numër të vogël lektorësh", "praktika të paqarta (të shkruara dhe jo të shkruara) të respektimit të etikës së gazetarisë" – anipse të gjithë të anketuarit janë anëtarë të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës", "praktika jo fort konsistente të publikimit të lajmeve nga jashtë vendit, praktika jokonsistente të procesit të ndreqjes dhe ndryshimit të lajmeve në procesin e publikimit të tyre, e kështu me radhë".[10] Sipas këtij raporti, del se mediat nuk ndërmarrin hapa konkretë ndaj një gazetari kur e gjejnë se ai ka shpërndarë përmbajtje keqinformuese, duke lejuar kështu vazhdimin e praktikave të këqija, dhe madje aty ngrihet dyshimi se në këtë mënyrë edhe redaktorët miratojnë prodhimin e këtyre lajmeve, qoftë edhe pa dashje, kur nuk imponojnë zbatimin e etikës së gazetarisë dhe të Kodit të KMSHK-së.[11]

[7] Ekspert i mediave, fokus-grupi i Hibrid.info, dhjetor 2022.

[8] Po aty.

[9] Në një rast një gazetar i një media serioze kosovare duke e marrë "copy-paste" lajmin nga mediat serbe kishte raportuar mbi "presidentin e Serbisë, kryeministrin e Malit të Zi dhe kryeministrin e shtetit të rremë të Kosovës." Po aty.

[10] Qerim Ondozi "Keqinformimi, Dezinformimi dhe Lajmet e Rreme në Mediat Online në Kosovë," Këshilli i mediave të shkruara të Kosovës, qershor 2022 Raporti_Keqinformimi_ALB_Final.pdf (presscouncil-ks.org), faqe 8.

[11] Po aty, faqe 8 dhe 9.

Kjo kritikë gjendet edhe në Barometrin e IREX-it ku thuhet se “shkeljet e shpeshta të standardeve të etikës nga mediat, rrallë shkaktjnë pasoja”.[12] Madje aty shtohet se gjuha e urrejtjes dhe dezinformimi janë të gjithëpranishme, veçanërisht në mediat online.[13] Vetë gazetarët dhe mediat mund të jenë të papërgatitura për njohjen përmbajtjeve keqinformuese, dhe kjo është shqetësuese edhe për KMSHK-në, sidomos pasi asnjë nga mediat e përfshira në hulumtimin e saj nuk kanë bashkëpunim me ndonjë platformë për verifikim faktesh.[14] Sidoqoftë, Barometri i IREX-it sqaron se prodhuesit profesionalë të përmbajtjeve si televizionet, radiot apo gazetatat online nuk prodhojnë apo shpërndajnë qëllimisht lajme të rreme apo çorientuese, por kjo mbetet megjithatë

domen i mediave online të cilat prodhojnë sasi të mëdha të informatave të rreme veçanërisht në mediat sociale.[15] Nga ato 468 biznese që janë të regjistruara në ARBK e të cilat aktivitetet primar kanë deklaruar median online, vetëm 50 prej tyre janë të anëtarësuar në KMSHK.[16] Pra afro 90% e mediave online, pa i marrë parasysh mediat e dyshimta, nuk kanë marrë përsipër zbatimin e Kodit Etik të KMSHK-së. Shumica e tyre publikojnë gjysmë-storje, të cilave u mungon konteksti, nuk citohen disa burime, bazohen vetëm në deklarata individuale të nxjerra nga mediat sociale, shumë prej tyre bazohen në burime anonime a në një burim të vetëm.[17] Këto trende sipas IREX-it flasin për rënie të profesionalizmit në media.[18]

Disa ekspertë mediash i kanë identifikuar tre gjeneratorë kryesorë të keqinformimit në Kosovë:

- i) paraja, apo burimet e paqarta dhe të panjohura të financimit të shumë prej mediave, veçanërisht atyre online,**
- ii) politika, apo lidhja e shumë prej mediave me parti politike dhe grupe interesi që shtojnë përpara interesa politiko-financiare, dhe**
- iii) importimi i narrativave të huaja në Kosovë, veçanërisht të atyre të mediave serbe të afërta me pushtetin atje dhe atyre ruse të cilat qëllim kanë propagandimin qoftë edhe përmes dezinformimit.[19]**

[12] IREX, Kosovo Vibrant Information Barometer 2022. VIBE_2022_Kosovo (1).pdf (irex.org), faqe 5.

[13] Po aty.

[14] Qerim Ondozi “Keqinformimi, Dezinformimi dhe Lajmet e Rreme në Mediat Online në Kosovë,” Këshilli i mediave të shkruara të Kosovës, qershor 2022 Raporti_Keqinformimi_ALB_Final.pdf (presscouncil-ks.org), faqe 9.

[15] IREX, Kosovo Vibrant Information Barometer 2022. VIBE_2022_Kosovo (1).pdf (irex.org), faqe 5.

[16] Ekspertët në fokus-grupin e Hibrid.info, dhjetor 2022.

[17] IREX, Kosovo Vibrant Information Barometer 2022. VIBE_2022_Kosovo (1).pdf (irex.org), faqe 4, 5 dhe 6.

[18] Po aty.

[19] Ekspertë mediash, fokus-grupi i Hibrid.info, dhjetor 2022.

Shih po ashtu Agon Sinanaj, “Kosovo Media Weigh Solutions to Boom in Fake News,” [Mediat kosovare i shqyrtojnë zgjidhjet ndaj shpërthimit të lajmeve të rreme] Balkan Insight, 01 Mars, 2022 Kosovo Media Weigh Solutions to Boom in Fake News | Balkan Insight

Mungesa e transparencës rreth pronësisë mbi mediat dhe mënyrave të tyre të financimit ka ndikuar fuqishëm në çrregullimin mediatik në Kosovë.[20] Mungesa e vetëqëndrueshmërisë financiare i ka bërë mediat të ndjeshme dhe të ekspozuara ndaj ndërhyrjeve politike dhe të bizneseve private, përfshirë transmetuesin publik RTK.[21] Ndonëse në Kosovë ekziston Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) në të cilin duhet të regjistrohet çdo biznes që të operojë në vend, të dhënat mbi pronësinë e mediave dhe financimin e tyre janë të kufizuara dhe jokredibile. [22] Në hulumtimet që janë realizuar për mediat, ka pasur raste kur përfaqësuesit e mediave kanë ngurruar të përgjigjen në këto pyetje, ose janë përgjigjur pjesërisht apo kanë refuzuar tërësisht të përgjigjen.[23]

Financimet dhe investimet për të pronësuar media kanë ndikim të madh mbi politikën redaktoriale, veçanërisht, siç thuhet nga IREX, gjatë kampanjave elektorale.[24] Ndërhyrjet politike ishin parë më së qarti në zgjedhjet lokale dhe parlamentare të vitit 2021, kur qenë themeluar një numër i madh mediash online nga grupe dhe individë të afërt

me partitë politike, dhe sa më shumë që kishin shpërndarë përmbajtje keqinformuese dhe sulme kundër oponentëve, aq më shumë lajmet e tyre kishin dominuar në mediat sociale.[25] Gjithashtu, në shumicën e mediave nuk ka ndarje të qartë mes funksioneve redaktoriale dhe atyre të menaxhmentit dhe shumë shpesh pronarët dhe menaxherët ndërhyjnë, madje edhe në lajme ditore e politika editoriale.[26]

Këto janë indikacione që shpien në drejtim të një lidhjeje mes mungesës së transparencës, pra fshehjes së pronësisë dhe burimeve të financimit dhe agjendave e interesave politike, gjeneratorë këta të konsideruar si kryesorë të keqinformimit. Çfarë ndodh kur futet në kombinimin edhe gjeneratori i tretë, narrativat dezinformuese, të cilat mund të arrijnë tek publiku kosovar shumë lehtë pasi nuk dihet se kush është pronari, nuk dihet se nga vjen financimi dhe, kësajsoj, plasohen narrativa dezinformuese nga grupe apo interesa jomiqësore ndaj Kosovës? Tash për tash, nuk ka kurrfarë pengesa për themelimin e një media online dhe nuk kërkohen kushte të veçanta për licencim.[27]

[20] Isuf Berisha, Media Ownership and Finances in Kosovo: Legal vacuum and lack of transparency [Pronësia dhe Financat e Mediave në Kosovë: Vakumi ligjor dhe mungesa e transparencës] (Trento, Italy: South East European Media Observatory, November 2015) <https://mediaobservatory.net/radar/media-integrity-report-media-ownership-and-financing-kosovo>

[21] Shih Raportin e Progresit të Komisionit Evropian mbi Kosovën 2022 Kosovo Report 2022.pdf (europa.eu), faqe 6.

[22] Isuf Berisha, Media Ownership and Finances in Kosovo: Legal vacuum and lack of transparency [Pronësia dhe Financat e Mediave në Kosovë: Vakumi ligjor dhe mungesa e transparencës] (Trento, Italy: South East European Media Observatory, November 2015) <https://mediaobservatory.net/radar/media-integrity-report-media-ownership-and-financing-kosovo> [23] Po aty.

[24] IREX, Kosovo Vibrant Information Barometer 2022 VIBE_2022_Kosovo (1).pdf (irex.org), faqe 9. Ky fakt del edhe nga fokus-grupi i organizuar nga Hibrid.info me ekspertë e gazetarë në dhjetor 2022.

[25] Po aty.

[26] Po aty.

[27] IREX, Kosovo Vibrant Information Barometer 2022 VIBE_2022_Kosovo (1).pdf (irex.org), faqe 8.

Narrativat dezinformuese mund të plasohen qoftë nga mosdija e mediave dhe gazetarëve të rinj, qoftë sepse ndjekin një interes financiar për të rritur klikueshmërinë apo, në rastin më të keq, duke u financuar nga interesa të caktuara. Për shkak të mungesës së kapaciteteve, gazetarët ka ndodhur ta citojnë edhe Sputnik-un apo Russia Today, krejt kjo nga mungesa e dijes dhe garës së ashpër për të publikuar lajme 24/7.[28]

[28] Ekspert nga fokus-grupi i Hibrid.info, dhjetor 2022.

III. RREGULLIMI DHE VETËRREGULLIMI I MEDIAVE

Duke marrë parasysh dobësitë e diskutuara aktuale të ekosistemit mediatik dhe atij politiko-institucional, kërkohet që institucionet të cilat detyrë primare e kanë rregullimin e sferës së mediave në Kosovë të angazhohen bashkë me gazetarët, mediat, dhe shoqërinë civile për eliminimin apo minimizimin e këtyre dobësive. Pavarësisht numrit të lartë të lajmeve keqinformuese dhe numrit të madh të mediave të dyshimta, përpjekjet e vetë mediave dhe gazetarëve janë drejt gjetjes së modeleve të mira të funksionimit dhe vetë-rregullimit të pavarur të mediave, përmes forcimit të zinxhirit institucional rregullues e vetërregullues.

Janë disa institucione që rregullojnë sferën e mediave në Kosovë si, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) i cili është institucion publik i themeluar sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe i rregulluar me ligj të veçantë, sipas të cilit ligj KPM i licencën transmetuesit publik e privat si dhe i përcakton dhe rregullon politikën e të drejtat e transmetuesve medialë audio-vizualë.[29] Është edhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) i cili është trup vetërregullues i themeluar nga mediat e shkruara për ta mbrojtur qytetarin nga shkrimet e

e pavërteta dhe gazetarin nga ankesat e pabazuara.[30] Dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), i themeluar si organizatë joqeveritare për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të gazetarëve, si dhe promovimin, inkurajimin dhe përmirësimin e gazetarisë cilësore dhe të hapur në Kosovë.[31]

Këto janë qëllimet ligjore dhe të vetë-deklaruara të këtyre organeve që marrin pjesë në rregullimin dhe vetërregullimin e fushës së mediave. Pavarësisht këtyre qëllimeve dhe punës së tyre, këto organe shpesh nuk arrijnë ta përmbushin misionin e tyre për shkak të mungesës së resurseve humane dhe financiare, për shkak të mungesës së fuqive ekzekutive dhe mekanizmave zbatues,[32] dhe për shkak se mjedisi politiko-institucional dhe zinxhiri i organeve të tjera të pavarura, si p.sh. gjyqësori i pavarur dhe efektiv, çalon.[33]

Sipas Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, i nxjerrë nga KPM, mediat mund të sanksionohen dhe procedohen nga KPM sipas ligjit të kësaj të fundit, madje edhe të urdhërohen ta ndërpresin transmetimin e përmbajtjeve të caktuara dhe ta humbin edhe licencën për transmetim.[34]

[29] Komisioni i Pavarur i Mediave, Për KPM Komisioni i Pavarur i Mediave (kpm-ks.org).

[30] Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, Për ne Press Council (presscouncil-ks.org)

[31] Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Rreth nesh Rreth nesh | Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës - AGK (agk-ks.org)

[32] Shih Raportin e Progresit të Komisionit Evropian mbi Kosovën 2022 Kosovo Report 2022.pdf (europa.eu), faqe 6, 34 dhe 94.

[33] Pika e fundit mbi dështimin e sistemit gjyqësor është ngritur në fokus-grupin e organizuar nga Hibrid.info në dhjetor 2022 si një nga problemet kryesore për mosrregullimin efektiv të problemeve në media.

[34] Komisioni i Pavarur i Mediave, Legjislacioni – Aktet nënligjore në fuqi, KKPM-2016/03 Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës Komisioni i Pavarur i Mediave (kpm-ks.org) dhe 1476189555.8908.pdf (kpm-ks.org) [dërgon direkt të Kodi].

Por KPM-së i mungojnë burimet njerëzore dhe të tjera që t'i ushtrojë detyrat e saj në mënyrë të pavarur.[35] Raporti i Progresit i Komisionit Evropian thotë gjithashtu se KPM nuk ka vendosur dënime efektive ndaj transmetuesve dhe as nuk ka ndërmarrë veprime serioze për zbatimin e tyre, pjesërisht edhe për shkak të mungesës së të dhënave mbi pronësinë e mediave.[36]

Për shumë gazetarë çështja e rregullimit të mediave përmes ligjeve dhe institucioneve publike apo politike siç është Kuvendi i Kosovës, është tejet problematike sepse kjo mund të shkaktojë keqpërdorim dhe përpjekje për kontroll politik të mediave. Sfidë është sesi të gjenden mënyra të financimit të institucioneve të vetë-rregullimit mediatic si p.sh. të KMSHK-së, në mënyrë që të rriten kapacitetet dhe efektshmëria e punës së këtij trupi drejt mbikëqyrjes dhe vetë-rregullimit të mediave. KMSHK-ja tash për tash ka vetëm rol rekomandues, nuk ka mekanizma të vet zbatues, ndonëse është i vetmi institucion para të cilit qytetarët dhe palët e ndryshme mund të ngrenë raste, dhe ajo mund të marri vendime vetëm kur dikush ngre çështje para saj.[37]

Ekspertë të mediave dhe verifikimit të fakteve janë kritik ndaj faktit që KMSHK është lënë në dorë të donatorëve dhe vetë-rregullimit kur ka mjaftueshëm raste në botë të cilat dëshmojnë se financimi nga shteti mund të sigurojë funksionimin e mirëfilltë të Këshillit në drejtim të përmbushjes së rolit të tij mbikëqyrës, edukues dhe si promovues vlerash në gazetari.[38] Në të vërtetë, gazetarët dhe ekspertët përmendin modele të shteteve të ndryshme që mund të merren parasysh për rregullimin e financimit të KMSHK-së si, Kroacia, Franca apo Holanda.[39] Dy të parat madje aplikojnë politikën e “name and shame” që do të thotë tregojë median e cila ka bërë shkelje dhe turpëroje në sytë e publikut duke ia dëmtuar kredibilitetin me qëllimin për ta edukuar që t’u përmbahet vlerave dhe etikës në gazetari.[40]

Në aspekt të kuadrit ligjor e institucional Kosova besohet se qëndron mirë. Vetë ideja e themelimit të KMSHK-së në vitin 2005 ka qenë që të ndiqen politika si të shteteve të mësipërme dhe që ky trup vetë-rregullohet të jetë strikt në zbatimin e kodit etik.[42] Gati dy dekada më vonë, në një mjedis të ri me shumë media online, me shumë parregullsi e shtrembërim informativ, të

[35] Komisioni i Pavarur i Mediave, Legjislacioni – Aktet nënligjore në fuqi, KKPM-2016/03 Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës Komisioni i Pavarur i Mediave (kpm-ks.org) dhe 1476189555.8908.pdf (kpm-ks.org) [dërgon direkt të Kodi].

[36] Shih Raportin e Progresit të Komisionit Evropian mbi Kosovën 2022 Kosovo Report 2022.pdf (europa.eu), faqe 34.

[37] Po aty.

[38] Agon Sinanaj, “Kosovo Media Weigh Solutions to Boom in Fake News,” [Mediat kosovare i shqyrtojnë zgjidhjet ndaj shpërthimit të lajmeve të rreme] Balkan Insight, 01 Mars, 2022 Kosovo Media Weigh Solutions to Boom in Fake News | Balkan Insight

[39] Intervistë me Kreshnik Gashin cituar në Qerim Ondozi “Keqinformimi, Dezinformimi dhe Lajmet e Rreme në Mediat Online në Kosovë,” Këshilli i mediave të shkruara të Kosovës, qershor 2022 Raporti_Keqinformimi_ALB_Final.pdf (presscouncil-ks.org), faqe 28.

[40] Ekspertët në fokus-grupin e Hibrid.info, dhjetor 2022.

[41] Po aty.

[42] Po aty.

karakterizuar nga pasiguri financiare e gjeopolitike, KMSHK ballafaqohet me sfida të reja. Sipas disa ekspertëve, zgjidhja e sfidave të reja çështja nuk arrihet vetë përmes ndryshimeve në kornizën ligjore, pasi që vlerësohet se Kodi i Mediave të Shkruara është mjaft i mirë dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë për raportim, duke u thirrur në parime e standarde etike. Sipas tyre mjafton edhe fuqizimi i KMSHK-së, në mënyrë që ta luajë rolin e tij për përmirësimin e situatës aktuale. [43]

Kodi i Mediave të Shkruara, në kapitullin II "Raportimi i së vërtetës" gjendet nënkapitulli II.1 për "Lajmet e rreme (Fake News)" i cili i përmban tri pika: 1) mediat duhet ta verifikojnë informacionin para se ta botojnë, 2) mediat duhet ta informojnë publikun kur nuk arrijnë ta konfirmojnë informacionin, dhe 3) mediat nuk duhet të botojnë dokumente të manipuluar.[44] Data e publikimit të këtij kodi në faqen e KMSHK-së është 27 tetor, 2022, që lë të nënkuptohet se është përditësuar rishtazi. Megjithatë, vetë emërtimi si "Lajme të rreme", tregon qartë se në hartimin e kësaj pjese të këtij Kodi, nuk janë konsultuar ekspertët e fushës. Termi "Lajm i rremë" nuk përfshinë gjitha format e çrregullimit informativ, pasi një përmbytje keqinformuese mund të publikohet edhe si dezinformatë, si

clickbait, manipulim faktesh edhe si lajm i rremë. Por duke marrë parasysh se KMSHK ka vetëm rol rekomandues dhe nuk ka mekanizma apo fuqi ekzekutive për zbatimin e vendimeve të saj, vetë-rregullimi i mediave duket se bëhet çështje vullneti e mediave dhe gazetarëve.

Por sa prej tyre do të dëshirojnë t'u përmbahen standardeve të etikës, kur interes primar mund të jetë përfitimi financiar apo agjendat politike?

Sipas ekspertëve, për të pasur një rregullim dhe vetë-rregullim funksional të mediave, duhet të funksionojnë të gjitha hallkat e sistemit institucional, jo vetëm të atij që rregullon mediat por të sistemit të sundimit të ligjit dhe atij institucional në tërësi. Në këtë drejtim, pa gjyqësor efektiv, të paanshëm, që i shqyrton ankesat e palëve me kohë as puna e KMSHK-së nuk mund të jetë efektive.[45]

Është e qartë se duhet të ketë një rregullim të mediave por si dhe nga kush është çështje që kërkon diskutim të gjerë. Për mediat, gazetarët e ekspertët është gjithmonë çështje balance apo kufiri mes lirisë së shprehjes dhe rregullimit apo vetë-rregullimit të mediave, veçanërisht nëse ndërmerren iniciativa ligjore që mund ta cenojnë lirinë e medias.[46]

[43] Intervistë me Flutura Kusarin cituar në Qerim Ondozi "Keqinformimi, Dezinformimi dhe Lajmet e Rreme në Mediat Online në Kosovë," Këshilli i mediave të shkruara të Kosovës, qershor 2022 Raporti_Keqinformimi_ALB_Final.pdf (presscouncil-ks.org), faqe 15.

[44] Këto tri pika janë të paraqitura këtu krejt shkurtimisht, për t'i parë të plota shihni Kodin e plotë të KMSHK te Press Council (presscouncil-ks.org).

[45] Ekspertët në fokus-grupin e Hibrid.info, dhjetor 2022.

[46] Po aty.

Por ata konsiderojnë se nuk ka zbrazëti ligjore, ka vetëm ngecje në zbatim, sepse KPM dhe KMSHK kanë autoritet dhe janë faktorë lehtësues në procedura gjyqësore dhe ekspertiza e tyre merret parasysh kur bëhet fjalë për shpifje dhe fyerje. Në fund të fundit, duhet gjetur mënyra për ta forcuar KMSHK-në dhe për t'i siguruar vetë-qëndrueshmëri financiare që ajo ta luajë rolin e saj më efektivisht. Roli më fundamental megjithatë, është ai vetë-rregullues, që mund dhe duhet të luhet nga vetë mediat e gazetarët. Pa përpjekjet e tyre për t'iu përmbajtur standardeve profesionale, për t'iu përmbajtur etikës së të bërit gazetari, kodeve të etikës të KPM dhe KMSHK, pa vullnetin e tyre që të krijojnë gazetari të standardeve të larta, nuk ka asnjë mekanizëm ligjor apo institucional që do të mund t'iu garantonte mediave funksionim të mirëfilltë dhe pa probleme.

Bazuar në trajtimin dhe analizën e të dhënave primare mbi të cilat u ndërtua ky raport, kuptohet se keqinformimi mbi dhe rreth ngjarjet politike është më i larti. Pra audienca kosovare bie shpesh pre e informacioneve të shtrembëruara për ngjarjet politike e të sigurisë. Ndërsa, metoda më e shpeshtë e keqinformimit për gjashtëmuorin e dytë të vitit të kaluar është përmes formës së dezinformimit.

Analiza krahasuese midis llojit më të shpeshtë të çinformimit që ishte dezinformata me temat e fushës politike dhe të sigurisë si më dominueset, na tregojnë se prodhimi dhe publikimi i përmbajtjeve keqinformuese është bërë me qëllim të krijimit të një narrative dezinformuese. Kjo analizë krahasuese vjen duke u bazuar në atë se dezinformata si formë e keqinformimit përdorët kryesisht për të përcjellë qëllimshëm agjendë propaganduese. Përmbajtjet që i posedojnë këta dy faktorë vijnë kryesisht si deklarata të zyrtarëve të lartë politikë e institucionalë nga Serbia dhe artikujve të disa mediave në gjuhën serbe për dhe rreth ngjarjeve e zhvillimeve në Kosovë.

Përmbajtjet e publikuara e shpërndara nga këto dy lloj burimesh, përpos si dezinformata, janë vlerësuar kryesisht edhe si manipulim i fakteve e teori konspirative. Edhe këto dy lloj vlerësimesh japin indikacione se arsyeja e prodhimit dhe shpërndarjes së përmbajtjeve të tilla është bërë me qëllim keqinformimi, si pjesë e një narrativi politik.

Temat që janë përdorur kryesisht nga burimet e lartpërmendura janë ndërlidhur kryesisht me ngjarjet në veri të Kosovës, raportet Kosovë-Serbi, ngjarjet dhe zhvillimet në komuna e rajone të banuara me shumicë serbe në Kosovë dhe të ngjashme.

Në anën tjetër, temat që ndërlidhen me çështje sociale, në masë të madhe janë përdorur për të prodhuar përmbajtje të vlerësuar si clickbait. Nëse bëhet analizë e krahasimit të këtyre dy faktorëve – llojet e temave dhe vlerësimit – rezulton që përmbajtjet e këtij kombinimi nuk kanë pasur domosdoshmërisht qëllim dezinformimi. Ky lloj kombinimi është bërë kryesisht për qëllime tjera materiale të prodhuesve e shpërndarësve të këtyre përmbajtjeve.

Përdorimi i temave sociale për të bërë artikuj clickbait është bërë në masë të madhe nga mediat vendore, të dominuar nga ato në gjuhën shqipe.

DISA NGA FORMAT E RREGULLIMIT TË FUSHËS INFORMIMIT NË KOSOVË, RRJEDHIMISHT SHMANGIEN ÇRREGULLIMIT INFORMATIV:

1

Angazhim për edukim të vazhdueshëm të mediave

Mekanizmat dhe akterët që ndërlidhen me mbikëqyrjen e sektorit të mediave si KPM dhe KMSHK, organizatat tjera që ndërlidhen me fushën e gazetarisë dhe medias si AGK dhe vetë mediat e gazetarët, mund të angazhohen për edukim të vazhdueshëm të mediave në fusha të ndryshme, duke filluar nga raportimi profesional sipas standardeve gazetareske dhe të etikës e deri te njohja dhe verifikimi i lajmeve dhe fakteve para se ato të botohen.

2

Përfshirje e shoqërisë civile dhe të qytetarëve

Vetë ekspertët e përfshirë në fokus-grup rekomandojnë përfshirjen e shoqërisë civile dhe të qytetarëve, meqenëse, siç vlerësojnë, roli aktual i mekanizmave përkatës është i kufizuar. Si shembull ilustrues të këtij vlerësimi kanë përdorur faktin që KPM-së ka mungesë të kapaciteteve njerëzore dhe që, aktualisht, operon me vetëm tetë monitorues.[47] Apo sikur rasti i KMSHK-së, mekanizëm ky që, nuk ka kompetenca të ndërmarrë iniciativë për të reaguar ndaj lajmeve keqinformuese që prodhohen në media, por varet nga ankesat që mund t'i shtrojnë palët e treta.

[47] Eksperte në fokus-grupin e Hibrid.info, dhjetor 2022.

Për mediat

1

Rekomandohet që mediat të ndërtojnë praktika të qarta të identifikimit të burimeve dhe verifikimit të fakteve para publikimit të lajmit,[48] dhe redaksitë të ndërtojnë praktika të respektimit të kodeve të etikës dhe të gazetarisë në përgjithësi e veçanërisht të ndërmarrin masa ndaj gazetarëve që bëjnë shkelje për të parandaluar përsëritjen e tyre.

2

Gjithashtu, duhet të shtohen redaktorët e lektorët përgjatë tërë zinxhirit të prodhimit e redaktimit të lajmit deri te publikimi i tij për të siguruar profesionalizëm[49] dhe minimizuar keqinformimin.

Për institucionet

1

Publikut të gjerë i mungojnë njohuritë për të bërë dallime mes mediave online, nëse ato janë autentike apo jo, nëse kanë të dhëna mbi redaksinë, pronësinë apo nëse kanë informata kontaktimi.[50] Prandaj edhe institucionet qeveritare mund të angazhohen dhe të bëjnë më shumë për edukimin medial, për krijimin e një ambienti të sigurt për punë, qoftë duke i trajtuar më me seriozitet kërcënimet ndaj gazetarëve apo edhe duke e zbatuar ligjin e punës,[51] çka do të ndikonte në shtrirjen e rregullsisë edhe në fusha të tjera të mediave.

2

Futja e lëndës së edukimit mediatik në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës mund të jetë vetëm çështje kohe duke parë se shtrembërimi informativ është tashmë realitet i cili nuk do të zhduket shpejtë.

[48] Qerim Ondozi "Keqinformimi, Dezinformimi dhe Lajmet e Rreme në Mediat Online në Kosovë," Këshilli i mediave të shkuara të Kosovës, qershor 2022 Raporti_Keqinformimi_ALB_Final.pdf (presscouncil-ks.org), faqe 34.

[49] Eksperte në fokus-grupin e Hibrid.info, dhjetor 2022.

[50] Eksperte në fokus-grupin e Hibrid.info, dhjetor 2022.

[51] Eksperte në fokus-grupin e Hibrid.info, dhjetor 2022.

METODOLOGJIA DHE TERMINOLOGJIA

Metodologjia e përdorur për përpilimin e këtij raporti përbëhet nga një qasje kuantitative dhe kualitative.

Në pjesën kuantitative përfshihet analiza e raporteve mujore monitoruese të Hibrid.info mbi keqinformimin, të publikuara nga muaji korrik e deri në muajin shtator. Në këto raporte mujore janë trajtuar kontrollet e fakteve të rregullta ditore nga hibrid.info.

Ndërsa, të dhënat kualitative janë marrë nga organizimi i një fokus grupi me ekspertë mediash e gazetarë me përvojë i realizuar në dhjetor të vitit 2022 si dhe nga një punë hulumtuese (desk research), konsultim i raporteve të organizatave ndërkombëtare mbi mediat në Kosovë dhe rajon, raporte vendore e institucionale. Pra përdoret një metodologji e kombinuar kuantitative dhe kualitative.

Baza e këtij raporti është ndërtuar nga gjetjet e raporteve mujore monitoruese dhe të fokus grupit, që kanë shërbyer për si burime për nxjerrjen e të dhëna primare. Ndërsa gjetjet nga hulumtimi i materialeve, janë përdorë si të dhëna dytësore për të përforcuar analizën e atyre primare.

Shprehja “çrregullim informativ” do të përdoret në këtë raport për të shënuar shumësinë e mënyrave të ndryshme të informimit të shtrembëruar, të atij lloj informimi që e përçon lajmin si të paplotë, të pavërtetë apo të rremë, duke mos informuar në mënyrë të drejtë dhe të saktë, duke informuar në mënyrë selektive dhe të anshme, për çfarëdo qëllimesh, dhe kështu duke ndikuar në krijimin e një mjedisi të çrregullt informativ.

Ndonjëherë shprehjet si “keqinformim” apo “dezinformim” do të përdoren si sinonime për ta shprehur këtë shumësi çrregullimi informativ, për thjeshtësi argumenti. Ashtu siç do të përdoren edhe shprehjet politik, politike, politikë, për të nënkuptuar diçka më të gjerë sesa vetë fusha e politikës së përditshme.

Fjalorthi

RAPORTIM I NJEANSHEM

Vlerësim si "Raportim i njëanshëm" merr ai raport mediatik i cili vërehet qartë se bënë favorizim të fakteve, qëndrime dhe përfundime që përputhen me një narrativë të veçantë, shpesh duke mos respektuar rregullin e kontaktit me palën tjetër kur bëhet fjalë për pretendime që janë të dëmshme për reputacionin e dikujt ose të portretizuar nga akterë të caktuar me një qasje negative. Një nga format e raportimit të njëanshëm është paraqitja selektive e fakteve, ku theksohen fakte që mbështesin një tezë të caktuar, ndërsa faktet që nuk e konfirmojnë atë janë lenë pas dore.

MANIPULIM I FAKTEVE

Vlerësimin si "Manipulim i fakteve" marrin ato raportime mediatike që përdorin fakte të njohura si të sakta, por i interpretojnë ato në mënyrë të shtrembëruara. Këto raporte zakonisht përdorin informacion të saktë për të nxjerrë përfundime ose pretendime të pasakta, duke drejtuar kështu përfundimet e konsumatorëve të përmbajtjes së mediave në drejtim të gabuar në lidhje me kuptimin aktual të fakteve të paraqitura.

LAJM I RREMË

Vlerësimin "Lajm i rremë" e marrin ato raportime mediatike që janë tërësisht prodhim i një mediumi i cili në vete përmban pretendime ose informacione faktikisht të gabuara. Përmbajtja që vlerësohet si lajm i rremë mund të përcaktohet me siguri se është krijuar dhe shpërndarë me qëllim të dezinformimit të publikut, d.m.th., për të paraqitur një pretendim që është plotësisht i rremë si fakt.

CENZURA

Etiketa "Censura" u epet përmbajtjes së atyre mediave që rezultojnë të censurohen pjesërisht ose plotësisht. Këto janë përmbajtjet që hiqen menjëherë pas botimit, pa një sqarim të qartë nga bordi redaktues. Në këtë kuptim, do të bëhet një dallim midis stilistikës dhe llojeve të tjera të azhurnimeve, duke pasur parasysh që censura kryesisht i referohet përmbajtjes që merret me ndjeshmëri politike dhe tema me interes publik, dhe të cilat janë "zhdukur" pa ndonjë arsye të qartë.

CLICKBAIT

"Clickbait" janë ato tekste titulli i të cilave nuk kanë asnjë bazë në përmbajtjen e tekstit vijues. Tekste dhe artikuj të tillë synojnë të tërheqin vëmendjen e lexuesit apo edhe konsumatorit me një titull sensacional duke premtuar përmbajtje që nuk ekziston në të vërtetë dhe janë krijuar kryesisht nga interesi financiar, domethënë për shkak të rritjes së lexueshmërisë. Pra, ky lloj teksti ka për qëllim vetëm klikimin, i cili mund të shndërrohet në përfitim të prodhuesit të përmbajtjes.

TEORI KONSPIRATIVE

Vlerësim si "Teori konspirative" marrin ato raportime mediatike të cilat shpërndajnë një përshkrim të rremë ose të paverifikueshëm të një dukurie, ngjarje ose një personi, duke e paraqitur atë si pjesë ose rezultat të një plani të fshehtë ("komplot"). Karakteristikë e këtyre raportimeve është se ato paraqesin një seri pretendimesh, të paraqitura si fakte, midis të cilave vendosen marrëdhënie shkak-pasoje, pa ofruar ndonjë provë të besueshme.

DEZINFORMATA

Vlerësimin si "Dezinformata" e merr ai raportim mediatik i cili në vete përmban një "miks" të burimeve të pasakta apo edhe përmbajtje gjysmë të vërtetë. Gjithashtu, ky vlerësim do të trajtojë raporte që kanë attribute të gabuara ose tituj që nuk pasqyrojnë tekstin për sa i përket saktësisë së informacionit.

TRANSMETIMI I LAJMEVE TË RREMË

Ky vlerësim u jepet raporteve të mediave në të cilat transmetohet përmbajtja origjinale e një mediumi tjetër, i cili përmban një lajm të rremë. Vlerësimi jepet vetëm për transmetimin e përmbajtjes që kategorizohet si lajm i rremë.

PËRMBAJTJE E PA VERIFIKUAR

Vlerësimi "I pa verifikuar" u bëhet atyre raporteve mediatike që nuk ofrojnë informata të mjaftueshme për të konfirmuar pretendimet e bëra në raport, dhe të cilat nuk kanë mundur konfirmojnë të njëjtat për shkak të mungesës ose mos-posedimit të burimeve të besueshme.

GABIMI

Vlerësimin "Gabim" e marrin raportet në media në të cilat redaksia e mediave bënë një gabim duke publikuar informacion të pasaktë ose duke transmetuar lajme të pavërtetuara nga një burim tjetër, pa qëllimin e qartë të dezinformimit të publikut.

PSEUDOSHKENCË

Vlerësim si "Pseudoshkencë" merr ai raportim mediatik që përqipet të paraqesë disa mendime, qëndrime, vlera ose gjetje të marra nga një metodë jo-shkencore dhe ti paraqesë ato si zbulime shkencore ose fakte. Raporte të tilla shpesh keqinterpretojnë ose manipulojnë kërkimet shkencore ekzistuese, ose i referohen hulumtimeve që janë në kundërshtim me verifikimin shkencor dhe gjetjen e fakteve.

SPINI

Vlerësimi "Spin" i jepet një raport mediatik me të cilin autori përqipet të largojë vëmendjen e publikut nga disa përmbajtje ose fakte të tjera që raportohen në media në atë kohë. Karakteristikë e raporteve të tilla në media është përpjekja që ato të ndodhin kryesisht si reagim ndaj një raporti tjetër mediatik ose një ngjarje aktuale nga e cila dikush dëshiron të largojë vëmendjen, dhe e cila është e pafavorshme për disa akterë, kryesisht politikë. Ky vlerësim është pra specifik për faktin se mund të varet nga faktore të jashtëm, siç janë rastet kur një medium i veçantë injoron lajmet e tanishme të pafavorshme nga njëra anë, dhe në të njëjtën kohë publikon përmbajtje që është e pafavorshme nga ana tjetër.

DEMANTIM

Vlerësimi "Demantim" është një vlerësim shtesë, i cili jepet në rastet kur media përcakton se përmbajtja e publikuar është në njërin prej kategorive të mësipërme të vlerësimeve negative, dhe në përputhje me këtë njohuri e mohon atë 1) në përputhje me faktet 2) në mënyrë të dukshme, në përputhje me parimet e botimit të mohimeve.

SATIRA

Vlerësimi i "Satirës" përfshinë përmbajtjen e cila përdor lajme të paramenduar që përdorin satirën për të treguar realitetin. Ky është edhe një mënyrë e raportimit i cili nuk është problematik, nëse media arrin të argumentojë se bëhet fjalë për një përmbajtje satirike.



HIBRID.INFO

ÇRREGULLIMI

INFORMATIV

NË PERIUDHËN E DYTË

TË VITIT

2022